



Министерство за образование и наука  
Биро за развој на образованието

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА  
МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА  
Биро за развој на образованието  
Бр. 08-3364/2  
14. 09. 2011 год.  
СКОПЈЕ

Drejtorit të Shkollës së mesme

Të nderuar,

Në pajtim me Ligjin për Byronë e zhvillimit të arsimit, si dhe Ligjin për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm, në dhjetor të vitit 2010 nga Byroja e zhvillimit të arsimit është përpiluar Koncepti për përpilimin e tekstit shkollor dhe Metodologjia për vlerësimin e tekstit shkollor.

Byroja e zhvillimit të arsimit në kuadër të ndihmës profesionale këshillëdhënëse në bashkëpunim me Zyrën e UNICEFIT në Shkup, për realizimin e suksesshëm të Konceptit për përpilimin e tekstit shkollor dhe metodologjisë për vlerësimin e tekstit shkollor, në periudhën që vijon do të organizojë prezantime të konceptit dhe metodologjisë, me mësimdhënësit të cilët kanë qenë deri tani ose në të ardhmen planifikojnë të jenë autorë ose recensues të teksteve shkollore për shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e prezantimit të Metodologjisë për vlerësimin e teksteve shkollore, kriteret dhe indikatorët të cilët do të duhet t'i udhëheqin komisionet recensuese gjatë vlerësimit të dorëshkrimeve për tekstet shkollore. Obligohen drejtorët e shkollave t'i njohin të punësuarit me mundësi për pjesëmarrjen në prezantim. Pjesëmarrësit e prezantimeve mund të paraqiten individualisht ose nga drejtori dhe shërbimet e shkollës, më së voni deri më 30 shtator 2011. Paraqitja mund të bëhet në formë të shkruar apo elektronike edhe atë në adresën e Byrosë së zhvillimit të arsimit rr. Rugjer Boshkoviq pn, Shkup (formë të shkruar) dhe në e-mail adresë: [igorjurukov@bro.gov.mk](mailto:igorjurukov@bro.gov.mk) (forma elektronike).

Në bazë të mësimdhënësve të paraqitur shkollat dhe mësimdhënësit do të jenë të informuara për datën dhe vendin e mbajtjes së prezantimit për Konceptin për përpilimin e tekstit shkollor dhe metodologjisë për vlerësimin e tekstit shkollor.

Me respekt,

Përpiloi: Mr. Igor Jurukov  
Kontrolloi: Mr. Mitko Çeshllarov

Drejtor  
Mr. Vesna Horvatoviq

